

01.07.2020

KONTRATË



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA SUHAREKË
KONTRATË

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKË REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
MARË NË DORËZIM		PRIMJENO - RECEIVED	
Nësi org. Org. Jeshlica Org. Unit	Numri Braj Number	Shtojca Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
01	351	26949	2

KOMUNA SUHAREKË (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), te cilën e përfaqëson Mustafë Buzhala zyrtar i zyres së prokurimit dhe menaxheri i kontratës i/e caktuar me Aktvendim nga ZKA dhe në PMK nga njësia e kërkesës, në njërën anë dhe: N.SH.H."ZONA PARK", PARKU I QYTETIT, -, PRIZREN, me numer unik identifikues 70786214 të cilën e përfaqëson Besnik Hoti, në anën tjetër janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

Titulli i kontratës
Dezinfektimi,dezinsektimi, dhe deratizimi DDD
Nr.prokurimit: 624- 20-047-236/624-20-2152-2-3-6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: Shërbimet e Dezinfektimi,dezinsektimi, dhe deratizimi DDD, sipas specifikimit të detyrueshme të dhëna me dosje të tenderit me kuotim të çmimeve.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me 01/07/2020 dhe përfundon pas (20) dite pune, siq është parapare me dosje të tenderit.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 1 ditë nga data e marrjes së urdhërësës.

1.4 Vendi i kryerjes së shërbimit është në teritorin e Komunës së Suharekës sipas specifikimeve teknike të detyrueshme të aneksit 1 të dhënë me dosje të tenderit.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi**3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: 958,10 € (nëntëqind e pesëdhjetë e tetë euro e dhjetë cent)**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro nga njësia e kërkesës. **Autoriteti Kontraktues do të lejoj pagesat, ku operatori ekonomik duhet të sjellë faturën për kryerje të shërbimeve dhe raportin e nënshkruar nga mbikëqyrësi dhe menaxheri i kontratës nga njësia e kërkesës në llogarin bakare të OE:**

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 10 ditë, pas pranimit të shërbimeve.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me

0,25% në ditë të vlerës së **shërbimeve** të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në **gjykatën kompetente** në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi


14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën **Shqipe** në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

Kontakt numri i Operatorit ekonomik 045-566-667

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Besnik Hoti	Emri:	Mustafë Buzhala
Pozita:	Përfaqësues	Pozita:	Zyrtar i zyres se prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	01/07/2020	Data:	01/07/2020
Vula:	 vv	Vula:	 vv

- ZONA PARK -

Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE / RITENDER					
Paramasat per Sherbimet e Dezinfektimit ,Dezinsektimit dhe Deratizimit –Ethet Hemoragjike ne zonat Endemike ne Komune te Suharekes					
Nr	Përshkrimi	Njesia	Sasia	Çmimi	Totali
1	Dezinfektimi selektiv kundër etheve hemoragjike(EHKK) në Komunene e Suharekës (Nishor ,Kasterc , Breshanc , Semetisht , Dobërdelan , Samadrexhë , Studençan , Peqan , Sllapuzhan , Bllacë , Duhël dhe qyteti-Suharekë	HA	244	€ 1.00	244.00 €
2	Dezinfektimi, deratizimi dhe dezinsektimi I Objektivit të Komunes	m2	1670	€ 0.09	150.30 €
3	Dezinfektimi, deratizimi dhe dezinsektimi I Objektivit të QPS	m2	170	€ 0.10	17.00 €
4	Dezinfektimi, deratizimi dhe dezinsektimi I Objektivit të Bibliotekës	m2	1300	€ 0.09	117.00 €
5	Dezinfektimi, deratizimi dhe dezinsektimi I Objektivit të Gjendja Civile	m2	528	€ 0.10	52.80 €
6	Dezinfektimi, deratizimi dhe dezinsektimi I Objektivit të QKMF dhe Emergjence	m2	1800	€ 0.09	162.00 €
7	Dezinfektimi, deratizimi dhe dezinsektimi I Objektivit të QMF - Mushtisht	m2	230	€ 0.10	23.00 €
8	Dezinfektimi, deratizimi dhe dezinsektimi I Objektivit të QMF - Bukosh	m2	230	€ 0.10	23.00 €
9	Dezinfektimi, deratizimi dhe dezinsektimi I Objektivit të QMF -Gjinoc	m2	230	€ 0.10	23.00 €
10	Dezinfektimi, deratizimi dhe dezinsektimi I Objektivit të QMF - Mohlan	m2	230	€ 0.10	23.00 €
11	Dezinfektimi, deratizimi dhe dezinsektimi I Objektivit të QMF - Studençan	m2	230	€ 0.10	23.00 €
12	Dezinfektimi, deratizimi dhe dezinsektimi I Objektivit të QMF -Duhël	m2	230	€ 0.10	23.00 €
13	Dezinfektimi, deratizimi dhe dezinsektimi I Objektivit të AMF -Sopijë	m2	70	€ 0.10	7.00 €
14	Dezinfektimi, deratizimi dhe dezinsektimi I Objektivit të AMF - Greikoc	m2	70	€ 0.10	7.00 €
15	Dezinfektimi, deratizimi dhe dezinsektimi I Objektivit të AMF - Leshan	m2	70	€ 0.10	7.00 €
16	Dezinfektimi, deratizimi dhe dezinsektimi I Objektivit të AMF - Sdamadrexhë	m2	70	€ 0.10	7.00 €
17	Dezinfektimi, deratizimi dhe dezinsektimi I Objektivit të AMF - Dobërdelan	m2	70	€ 0.10	7.00 €
18	Dezinfektimi, deratizimi dhe dezinsektimi I Objektivit të AMF - Semetisht	m2	70	€ 0.10	7.00 €

19	Dezinsektimi, deratizimi dhe dezinfektimi I Objektit te AMF -Nishor	m2	70	€	0.10	7.00 €
20	Dezinsektimi, deratizimi dhe dezinfektimi I Objektit te AMF -Reqan	m2	70	€	0.10	7.00 €
21	Dezinsektimi, deratizimi dhe dezinfektimi I Objektit te AMF - Budakovë	m2	70	€	0.10	7.00 €
22	Dezinsektimi, deratizimi dhe dezinfektimi I Objektit te AMF - Sallagrazhdë	m2	70	€	0.10	7.00 €
23	Dezinsektimi, deratizimi dhe dezinfektimi I Objektit te AMF -Bllacë	m2	70	€	0.10	7.00 €
Shuma Totale						958.10 €

✓
✓
✓
✓
✓
2X